

TAKIM I EKIPIT TEMATIK PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, e përfaqësuar nga znj. Patricia Pogaçe, ishte pjesë e takimit të Ekipit Tematik në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 - 2030, i drejtuar nga Zv. Ministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta dhe znj. Elona Hoxha, Drejtoreshë pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë.



TAKIME INFORMUESE NË PEQIN DHE RROGOZHINË MBI NDIHMËN JURIDIKE FALAS NË BASHKITË E VOGLA

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Shqipëri, zhvilloi takime informuese në Bashkinë Peqin dhe Bashkinë Rrogozhinë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtën për ndihmë juridike falas. Fokusi i këtyre takimeve ishte krijimi i urave të bashkëpunimit ndërmjet DNJF dhe bashkive të vogla, për të siguruar akses të barabartë në drejtësi për çdo qytetar.



TRYEZË PUNE ME PËRFAQËSUES NGA MINISTRIA E DREJTËSISË DHE ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas organizoi një tryezë pune me përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë dhe organizatat jofitimprurëse të licencuara për ofrimin e ndihmës juridike. Takimi, në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, shërbeu si një platformë për diskutim mbi objektivat strategjike dhe nevojat prioritare.



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME "ALBANIAN UNIVERSITY"

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga "Albanian University" me temë: "Integrimi i digjitalizimit në sistemin ligjor, psikologjik dhe arsimor. Mundësitë, sfidat dhe ndikimet në të ardhmen e shoqërisë". Me këtë aktivitet "Albanian University" bëhet universiteti i 13 me të cilin DNJF ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave të punës dhe trajnimeve për studentët.



MBËSHETJA E AKSESIT TË QYTETARËVE NË DREJTËSI NËPËRMJET NDËRMJETËSIMIT NË SHQIPËRI

Drejtoresha e Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore, znj. Patricia Pogace dhe specialisti i QSHNJP Kurbin morën pjesë në një takim të organizuar në kuadër të projektit “Mbështetja e aksesit të qytetarëve në drejtësi nëpërmjet ndërmjetësimit në Shqipëri”.



TAKIM ME GAZETARË DHE PËRFAQËSUES TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas zhvilloi një takim informues dhe konsultues me gazetarë dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në kuadër të zbatimit të Direktivës së BE 2024/1069 “Për mbrojtjen e personave që angazhohen në pjesëmarrjen publike nga paditë abuzive (Anti - SLAPP)”.



TRAJNIM MBI NDIHMËN JURIDIKE FALAS ME STUDENTË TË KLINIKËS SË LIGJIT TË “ALBANIAN UNIVERSITY”

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas zhvilloi në datën 29.05.2025 trajnimin mbi ndihmën juridike falas me studentë të Klinikës së Ligjit pranë “Albanian University”. Trajnimi njohu studentët me ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.




AKTIVITETE TË ZHVILLUARA NGA QENDRAT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE



QSHNJP Korçë në datën 10.05.2025 zhvilloi, në bashkëpunim me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, një takim informues mbi drejtësinë dhe njohjen e ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” me nënësit e shkollës “Themistokli Gërmenji”.

QSHNJP Korçë në datën 15.05.2025, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes, realizoi një takim me persona përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe statusit të të verbërit.



QSHNJP Korçë në datën 20.05.2025 zhvilloi një aktivitet Street Law mbi informimin e qytetarëve për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, kategoritë përfituese dhe shërbimet që ofrohen pranë qendrës.



QSHNJP Korçë në datën 06.05.2025 mori pjesë në takimin e GTN ku u diskutua mbi rëndësinë e ndihmës juridike falas për të miturit.


QSHNJP Korçë në datën 30.05.2025 mori pjesë në takimin për rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR) kundër dhunës.

QSHNJP Durrës në datën 09.05.2025 ka zhvilluar një aktivitet Street Law, në bashkëpunim me studentët e universitetit “Aleksandër Moisiu”, në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë.





QSHNJP Durrës në datën 15.05.2025, në kuadër të Ditës Kombëtare të Familjes, organizoi pranë Qendrës Komunitare Multifunksionale Rrashbull një aktivitet informues mbi ligjin nr. 111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*.




QSHNJP Durrës në datën 20.05.2025 zhvilloi një takim me përfaqësues të Bashkisë Shijak. Gjatë takimit u diskutua mbi referimin e rasteve të qytetarëve që kërkojnë ndihmë juridike falas si dhe mbi përcjelljen e informacionit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.



QSHNJP Durrës në datën 23.05.2025 zhvilloi një takim pranë disa prej Njësive Administrative të qytetit si edhe pranë Gjendjes Civile ku u shpjegua në mënyrë të detajuar ligji nr. 111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*, shërbimet që ofrohen pranë qendrës dhe kategoritë përfituese.

QSHNJP Durrës në datën 26.05.2025 zhvilloi një aktivitet informues pranë Njësive Administrative nr. 5,12,16. Në këtë takim u shpjegua ligji nr. 111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”* dhe kategoritë përfituese të ndihmës juridike falas.

QSHNJP Durrës zhvilloi një takim me fokus promovimin e ndihmës juridike falas pranë Bashkisë Sukth. Gjatë takimit u shpreh nevoja për të bashkëpunuar në referimin e rasteve të qytetarëve që kanë nevojë për ndihmë juridike falas si edhe nevoja për të ndarë sa më tepër informacion lidhur me shërbimet që ofrohen pranë qendrës.



QSHNJP Përmet në datën 20.05.2025 zhvilloi një aktivitet Street Law ku u ofrua informacion i thjeshtëzuar mbi ndihmën juridike falas dhe kategoritë përfituese të saj.



QSHNJP Përmet dhe QSHNJP Gjirokastrë zhvilluan një aktivitet Street Law në qytetin e Gjirokastrës, në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë.

QSHNJP Përmet dhe QSHNJP Gjirokastrë në datën 09.05.2025 ishin të ftuara në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë ku u diskutua mbi ndihmën juridike falas si të drejtë themelore për aksesin në drejtësi.



QSHNJP Përmet dhe QSHNJP Gjirokastrë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes, zhvilluan një takim informues mbi të drejtat ligjore të qytetarëve dhe mënyrat se si ndihma juridike falas mbështet individët dhe familjet në nevojë për këtë shërbim.



QSHNJP Lushnje në datën 13.05.2025 zhvilloi një aktivitet informues Street Law, me fokus informimin e qytetarëve mbi ndihmën juridike falas dhe vendndodhjen e qendrës.



QSHNJP Lushnje zhvilloi në datën 27.05.2025 një aktivitet Street Law mbi promovimin e ndihmës juridike falas.

QSHNJP Shkodër ka zhvilluar një aktivitet Street Law, në bashkëpunim me studentët e universitetit “Luigj Gurakuqi”, me fokus informimin e qytetarëve mbi ligjin nr. 111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*.



QSHNJP Shkodër në datën 12.05.2025, në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë, zhvilloi një aktivitet Street Law me fokus informimin e qytetarëve mbi ndihmën juridike falas.



QSHNJP Shkodër në datën 16.05.2025 organizoi një takim pranë Strehëzës për fëmijë "Shtëpi - Familje". Fokus i takimit ishte te informimi i të miturve mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

QSHNJP Fier zhvilloi në datën 23.05.2025 një takim me psikologjen A. Delilaj pranë Qendrës Shëndetësore nr.1, Fier. Takimi u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit dhe krijimit të një qasjeje më të integruar ku kujdesi psikologjik dhe ndihma ligjore plotësojnë njëra-tjetrën, për individët që kanë nevojë për mbështetje.

QSHNJP Fier në datën 15.05.2025 zhvilloi një aktivitet Street Law, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes. Aktiviteti kishte si qëllim informimin e qytetarëve mbi shërbimet që ofron QSHNJP Fier.



QSHNJP Tropojë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes, organizoi një takim me nxënës të shkollës "Ali Podrimja". Në takim u diskutua mbi të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të familjes.

QSHNJP Tropojë zhvilloi në datën 23.05.2025 një aktivitet Street Law me fokus ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve mbi ndihmën juridike falas.



QSHNJP Tropojë zhvilloi në datën 27.05.2025 një takim pranë Zyrës Vendore të Punësimit dhe Aftësive Tropojë, ku u diskutua mbi bashkëpunimin ndërinstitucional dhe sfidat e përbashkëta në shërbim të qytetarëve.

QSHNJP Tropojë në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve mori pjesë në një aktivitet të organizuar nga Qendra Kulturore e Fëmijëve.

QSHNJP Vlorë, në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë, organizoi një takim informues mbi zhvillimet në sistemin e drejtësisë, me studentë të universitetit "Ismail Qemali".

QSHNJP Vlorë në datën 15.05.2025, në Ditën Ndërkombëtare të Familjes, zhvilloi një takim pranë Konviktit të Vajzave të universitetit "Ismail Qemali". Pjesëmarrëset në takim u informuan mbi shërbimet e ndihmës juridike falas, rëndësinë e familjes si institut dhe përgjegjësitë që vijnë nga krijimi i familjes.

QSHNJP Tiranë në datën 13.05.2025 zhvilloi një aktivitet Street Law në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë.



QSHNJP Tiranë ishte pjesë e aktiviteteve të zhvilluara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në bashkëpunim me OSBE, në Bashkitë Peqin dhe Rrogozhinë.

QSHNJP Mat në datën 12.05.2025 mori pjesë në takimin e organizuar nga Grupi Teknik Ndërsektorial ku u diskutua mbi rastet e dhunës në familje.

QSHNJP Mat në datën 13.05.2025 organizoi një aktivitet informues Street Law në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë.

QSHNJP Mat në datën 28.05.2025 mori pjesë në takimin e organizuar nga Grupi Teknik Ndërsektorial në Bashkinë Mat.

